Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0036

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Gent Gorani" kundër Vendimit për dhënie te një kontrate te aktivitetit te prokurimit të Telekomi i Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1", me 27/03/2024, mori:

Vendim

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e "Gent Gorani"- me nr. 2024/36 , e datës 09.01.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1" inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Telekomi i Kosovës Sh.A.

2.Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues -Telekomi i Kosovës Sh.A lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3.Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me15.05.2023 , Telekomi i Kosovës Sh.A. në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Krijimi realizimi i

reklamave për TV dhe Radio” me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1". Ndërsa me datën 20.12.2023. ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “Q.M Tema”

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 116,440.00 €.

Me 26.12.2023, OE “Gent Gorani” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 27.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 09.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Gent Gorani”me nr. 36/24 për lidhur me aktivitetin “Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio” me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1",.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues“Gent Gorani” janë parashtruar si në vijim**:**

Pretendimi *:* Përsëri kemi te bëjmë me te njëjtin pretendim si ne ankesën e mëparshme sa i përket te njëjtit aktivitet te prokurimit. Pra, pretendimi ynë te cilin edhe OSHP e vlerësoi si te bazuar sa i përket Mos plotësimit te Formularëve Standard sipas kërkesave/specifikimeve te vendosura nga AK. OE i shpallur fitues njëjtë si OE te tjerë te eliminuar nga gara nuk ka plotësuar Formularin standard - Lista e çmimeve sipas kërkesave/specifikimeve te kërkuara nga AK. Pra, OE "Q.M Tema" nuk ka plotësuar sipas kërkesave dhe sipas normave e ligjeve te RKS-se kolonat: 1) Norma E TVSh - nuk ka plotësuar këtë kolone sipas kërkesave/specifikimeve

teknike dhe as sipas Normave te përcaktuara nga ligjet e RKS. 2) Shënim Operatori Ekonomik - Nuk ka plotësuar kolonën me shënimin e OE, por ka vendosur shenjen NA - e cila nënkupton "No Answer." Jemi shume te habitur me faktin se si AK edhe ne fazën e rivlerësimit nuk respekton vendimin e OSHP-se, me te cilin ishin pajtuar me mendimin e ekspertit përkatësisht piken: Mosplotësimi i kushteve teknike dhe Formularit standard - Lista e çmimeve sipas specifikimeve konsiderohet si një mosplotësim i kërkesave të dosjes se tenderit dhe ndikon negativisht në vlerësimin e ofertës nga OE te eliminuar nga AK. Ky tejkalim gjate vlerësimit nga komisioni vlerësues dërgon në diskualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankues nga gara ose vlerësimin e tyre si ofertë jo e suksesshme. Për të qenë konkurrues në një procedurë të prokurimit publik, operatorët ekonomikë duhet të sigurohen që të plotësojnë të gjitha kushtet e kërkuara dhe të prezantojnë një ofertë të plotë dhe të rregullt në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktues. Edhe me shqetësuese është fakti se OE "Q.M Tema" shpallet fitues edhe pse tenton te beje evazion fiskal duke ofertuar Pa TVSh, ani pse ne ATK është i regjistruar si deklarues i Tvsh-së. AK pretendon se kemi te bëjmë me gabime ne përcaktimin e normës se TVSH-se, mirëpo ne këtë rast OE qartazi oferton pa TVSh për te gjitha pozicionet ne listën e çmimeve, si dhe Formularin e tenderit e plotëson pa TVSh po ashtu. Ky OE te njëjtën shkelje e praktikon edhe ne aktivitetet tjera publike ku ne te gjithat oferton pa TVSh. Me poshtë gjeni një aktivitet tjetër ku ky OE ka qene pjesëmarrës dhe oferton pa TVSH. Po ashtu, vlen te theksohet se ne rast te përmirësimit te Normës se TVSH-se, atëherë kemi mospërputhje te çmimit për njësi pa TVSh (çmim mbizotërues) dhe çmimit total me TVSH (çmimit me te cilin vlerësohet tenderi) dhe kështu gabimi aritmetikor është 18% dhe shpie direkt ne eliminimin e këtij OE te papërgjegjshëm. Ne tentuam te ia sqarojmë AK-se se OE i shpallur fitues, ka thyer edhe Ligjet e lëshuara nga institucionet e larta shtetërore dhe jo vetëm LPP. Andaj, nënshkrimi i kësaj kontrate ka baze ligjore për evazion fiskal dhe dëmtim te drejtpërdrejte te buxhetit te RKS. Ky vendim është po ashtu diskriminues ndaj tatimpaguesve te rregullt te RKS. Me poshtë gjeni edhe kërkimin e OE ne web faqen zyrtare te ATK-se, ku i njëjti figuron si deklarues i TVSH-se, ndërsa tenton te beje evazion fiskal duke pranuar te nënshkruajë një kontrate për te cilën ka ofertuar PA TVSH. Në ankesë gjeni të bashkangjitur Listën e çmimeve te dorëzuar nga OE "Q.M Tema".

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE "Gent Gorani" konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së si dhe neni 10, 10.1, 44, 44.3 të Udhëzuesit Nr.001/2023 Për Prokurimin Publik. Kërkojmë nga OSHP, qe këtë lende ta vlerësojë si te bazuar dhe ta trajtoje si "res judicata", pasi qe pretendimi është gjykuar me pare, dhe lënda te kthehet ne rivlerësim përsëri.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim : " Pretendimi I i bërë nga operatori ekonomik ankues, nuk qëndron për faktin se nenin përkatës të cilit i referohet operatori ekonomik Neni 36 Procedurat për kuotimin e çmimeve], paragrafi 2 të LPP -së, nuk ka të bëjë fare me procedurën e aplikuar nga autoriteti kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit, që është procedure e hapur. Përderisa, pjesa e dytë e pretendimit 1, citati;" 13.10 Në raste kur ka ndryshime sipas një vendimi të një organi kompetent, në tatime, normën e TVSH-së apo ndryshime në tarifat për import, çmimet e kontratës duhet të rregullohen në përputhje me rrethanat", nuk qëndron për faktin se kjo aplikohet në rast se tashmë ekziston një kontratë e nënshkruar mes palëve dhe si rezultat i

veprimeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues, atëherë autoriteti kontraktues do të duhej te përshtaste normat e TVSH-së apo edhe tarifat e importit në varësi të vendimeve të qeverisë. Norma e TVSH-së e dhënë nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij është "0 %", e cila besojmë se është bërë me vetëdijen e tij të plotë, duke pas për bazë edhe ligjet tjera të aplikueshme në republikën e Kosovës. Aplikimi i TVSH sipas ligjeve të administratës tatimore Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar] aplikohet në nivele të caktuar të qarkullimit vjetor. Po ashtu, në rast të nënshkrimit të kontratës autoriteti kontraktues nuk do bëjë ndryshim të kësaj norme tatimore, përderisa ajo është vendos nga vet nga operatori ekonomik dhe pasojat mundshme të gjobave të shqiptuara nga administrata tatimore do të barten nga vet operatori ekonomik. Pretendimi 2 i bërë nga operatori ekonomik ankues, nuk qëndron për faktin se nenin 59.3 i LPP-së nuk e konsideron gabim aritmetikor nëse operatori ekonomik "gabon" normën e TVSH-së. Për këtë çështje autoriteti kontraktues ka pasur interpretim nga KRPP për rast të njëjtë, në përgjigjen për kërkesën për rishqyrtim gjeni te bashkangjitur interpretimin. Prandaj, edhe bazuar në interpretimin e lartcekure KRPP-së, autoriteti kontraktues nuk ka mundësi ligjore që të eliminoj një operator ekonomik për veprim të tillë. Autoriteti kontraktues bazuar në nenin 108/A të LPP-së, dhe arsyet e cekura më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. “

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 11.01.2024 ka autorizuar eksperten për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 36/2024, ndërsa me datë 13.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/36 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në faktet, sqarimet e lartpërmendura dhe te gjeturat tjera ne këtë raport, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pa-bazuar, (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimet si më lartë) dhe të njëjtin tender rekomandojmë që të mbete në fuqi vendimi i AK lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues Pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit shqyrtues, ndërsa OE deklaron se Nuk Pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Gent Gorani" eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/36 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I): Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, bazuar ne dosjen e tenderit, Pjesa C – Formulari i tenderit, Lista e çmimeve - (Listën e çmimeve standarde e cila krijohet nga sistemi)si dhe neni 5.3 i FDT-se (Kushtet e dërgesës: DDP (detyrat e dërguara të paguara), AK – komisioni i ri-vlerësimit ka vepruar ne harmoni te plotë sipas nenit 59 par. 4 të LPP-së, ku thotë: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve", gjithashtu, ZPP ne vendimin mbi refuzimin e KpR si te pa bazuar te datës 27.12.2023, ka sqaruar ne mënyrë profesional ku e potencon edhe interpretimin e KRPP-se, nëse operatori ekonomik "gabon" apo/ose "nuk e vendos" normën e TVSH, Autoriteti Kontraktues do ta korrigjoj % (përqindjen) e atij apo atyre artikujve në bazë të normës së aplikueshme të TVSH-ës pa pasur nevojë të kërkoj sqarime shtesë nga Operatori Ekonomik në fjalë. Pavarësisht nga kjo si më lartë, duke marr për bazë këto sqarime si me lartë si dhe duke u bazuar ne dosjen e tenderit dhe Pjesa II - përshkrimin e çmimit, ku çmimi është kërkuar me TVSH (DPP) dhe OE i rekomanduar për dhënie te kontratës në formularin e tenderit ka vendosur çmimin me TVSH: 71,300.01EUR, i cili është identike me çmimin tek përshkrimi i çmimit me TVSH: 71,300.00 EUR, dhe ne pajtim me formularin për dorëzimin e tenderit konkretisht pikën 1 dhe 2, ku thotë: 1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim. 2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim: po ashtu kërkesa e TVSH është e përcaktuar ne FDT konkretisht ne nenin 2 te KPK te përcaktuar nga forma standarde e hartuar nga KRPP) ku thotë: 2.3 Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP (Dërgesat e Detyrës të Paguara), që do të thotë se furnizimet dhe shërbimet për këtë aktivitet te prokurimit, janë me te gjitha taksat, dhe kjo është kërkuar tek Pjesa II - përshkrimi i çmimeve - totali i përgjithshëm me TVSH, ndërsa lidhur me listën e çmimeve tek kolona "shënim për operatoret ekonomik" OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar "N/A" që do të thotë: "nuk aplikohet" dhe nuk është e domosdoshme te plotësohet përveç nëse OE e sheh te nevojshëm apo/ose autoriteti kontraktues e ka specifikuar ne dosje tenderit. Prandaj duke u bazuar ne këto fakte dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk janë të qëndrueshëm. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive të

dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, AK – komisioni i vlerësimit, ka respektuar nenin 59 të LPP-së, andaj Është përgjegjësi, dhe në diskrecion të Autoritetit Kontraktues, respektivisht komisionit të vlerësimit – ZPP, që procesi i vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të behet ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, ne këtë aktivitet te prokurimit, ne mënyrë qe të respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosje te tenderit si dhe te respektohen kriteret e dhënies. Eksperti shqyrtues sqaron, se autoritetet kontraktues janë te obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike te përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues duhet te këtë ne konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën më efikas, më transparent dhe më të drejt të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktivitetit të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, veprimet e ndërmarra nga autoriteti kontraktues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtuese. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetët në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues "Gent Gorani" lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Krijimi realizimi i reklamave për TV dhe Radio" me nr. të prokurimit: "TK-23-4036-1-2-1".

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **TELEKOMI I KOSOVËS SH.A.**
- OE - **Gent Gorani**
- Arkivës së OSHP-së: